

MBI
AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË
BASHKINË BERAT(PARKINGJET)

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Berat**, me objekt: “*Mbi auditimintematik të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në dhënien me partneritet publik të parkingjeve në rrugët e qytetit të Beratit*”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2013 deri më 30.10.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 174, datë 22.12.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 709/4, datë 26.12.2015, i ka rekomanduar z. Petrit Sinaj, Kryetar i Bashkisë Berat, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetjet nga auditimi: Bashkia Berat nuk ka respektuar të gjitha kriteret dhe procedurat ligjore në përcaktimin e kriterëve të përzgjedhjes së agjentit tatimor, për dhënien me pagesë të shërbimit të mbledhjes dhe administrimit të tarifës së parkimit në rrugë, sipas kontratës së bashkëpunimit datë 01.07.2013, me subjektin privat “*M....P..B....*” sh.p.k, duke nënshkruar një kontratë të disfavorshme për interesat e Bashkisë.

Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa që në dhënien me sipërmarrje private të shërbimeve, që do të bëjë për mbledhjen dhe administrimin e tarifës së parkimit me pagesë në rrugë, të krijojë grup pune me specialistë të fushës, të cilët duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë dhe qartë, kriteret e përzgjedhjes së konkurrentëve.

2. Gjetjet nga auditimi: Bashkia Berat ka nënshkruar kontratën me subjektin privat, pa kryer negocimin mbi kushtet e kontratës, detyrimet dhe penalitetet për mos përmbushje të kontratës nga palët, veçanërisht për kushtet që në rast mos përmbushje ose shkelje nga pala do të kishin pasoja financiare negative.

Rekomandimi: Në të gjitha kontratat që do të nënshkruhen nga Bashkia Berat, për sipërmarrje të kryerjes së shërbimeve, të mos miratohen, pa kryer procesin e negocimit mbi kushtet që do vendosen dhe garancitë e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që janë përcaktuar në kontratë.

3. Gjetjet nga auditimi: Në auditimin e kryer, u konstatua se nga mungesa e mbikëqyrjes së shërbimit dhe vjeljes së tarifës, keq menaxhimi dhe bashkëpunimi jo i efektshëm i Bashkisë me agjentin tatimor, ka bërë që të mos arkëtohet vlera prej **3,718,358 lekë, si dëm ekonomik**, përfituar padrejtësisht nga subjekti “*M...P... B...*” sh.p.k, vlerë e cila duhej të arkëtohej nga agjenti tatimor, i cili rezulton të ketë marrë vlerën e shërbimit, por nuk i është dhënë Bashkisë Berat.

Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore, për të vlerësuar dhe kërkuar arkëtimin e vlerës **3,718,358 lekë**, të përfituar padrejtësisht nga subjekti “*M...P...B....*” sh.p.k.

4. Gjetjet nga auditimi: Bashkia Berat për vitin 2014 dhe 6/mujorit të I e vijim të vitit 2015, megjithëse çështja ka kaluar në Gjykatën Administrative të Shkallës Parë Vlorë, pasojë e krijuar nga mosmenaxhimi dhe mbulimi i territorit nën administrim, duke mos aplikuar tarifën e parkimit me pagesë, buxhetit të bashkisë i janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën **5,787,357 lekë**, shumë kjo ardhur dhe nga mos llogaritja e arkëtimi i tarifave të institucioneve shtetërore e private që kanë parkim të rezervuar.

Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa dhe të ngrejë grup pune me specialist të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për të llogaritur dhe kërkuar administrativisht dhe ligjërisht arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara për vitin 2014 dhe 2015, nga institucionet shtetërore e private që kanë vende të rezervuara për parkime dhe persona fizik që kanë zënë parkimin.

5. Gjetjet nga auditimi: Bashkia Berat, pas prishjes së kontratës nuk ka menaxhuar tarifa parkimi, duke sjell pasojë mos përmbushjen e detyrave funksionale si njësi vendore në administrimin e territorit të

Bashkisë, kjo e shoqëruar me pasoja financiare negative për buxhetin e saj, pra të ardhura të munguara, dhe mos shfrytëzimin e tyre në interes publik.

Rekomandimi: Këshilli Bashkiak të analizojë me përgjegjësi Raportin Përfundimtar të Auditimit tematik, duke nxjerrë shkaqet e krijimit të kësaj situatë negative në dhënien e shërbimit të parkingjeve publike me “*agjent tatimor*”. Njëkohësisht të marrë masa për të mos u përsëritur mangësitë e trajtuara nga auditimi tematik, duke përcaktuar qartë kushtet e monitorimit të kontratave.

6. Gjetje nga auditimi:

a. Nga auditimi është konstatuar se kriteri “*afati kontratës*” i vendosur nga Komisioni, **me afat për 20 vjet**, është në kundërshtim me nenin 12 pika 4, të Udhëzimit nr. 7, datë 10.06.2008 “*Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të Parkimit me pagesë në Rrugë*” të ish-Ministrisë Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit”, duhet theksuar se ky afat është korrigjuar nga 20 vjet në 5 vjet në kontratën e shërbimit datë 01.07.2013 të lidhur midis Bashkisë dhe agjentit tatimor “Metro Parking Berat” sh.p.k.

b. Njëherazi në përcaktimin e këtij kriteri nuk janë marrë në konsideratë Vendimet e Këshillit Bashkiak, nr. 39, datë 29.10.2010 dhe nr. 26, datë 09.07.2012 “*Për rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryej administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë*”, pasi edhe këto dy vendime nuk kanë përcaktuar afatin kohor 20 vjet.

c. Bashkia Berat ka vendosur raport ndarje të ardhurave nga parkimi me pagesë, 80% shoqëria dhe 20 % Bashkia Berat, pa bërë një studim fizibiliteti paraprak dhe pa vendosur asnjë kriter raport fitimi në procedurën e konkurimit.

Rekomandimi:

a. Në procedurat e konkurimit për dhënie me sipërmarrje të shërbimeve publike si parkingjet etj., të vendosen afatet sipas kufizimeve ligjore.

b. Në analizën që do të kryejë Këshilli Bashkiak, të përcaktohen qartë detyrimet që duhet të zbatojë Bashkia, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë e mos zbatimit të Vendimit të KB nr. 39, datë 29.10.2010 dhe nr. 26, datë 09.07.2012 në afatet dhe kriteret e vendosura në kontratën e mëparshme.

c. Të kryhet studim dhe analizë e veçantë në përcaktimin e raportit të ndarjes së fitimit Bashki/shoqëri private, për të gjitha sipërmarrjet që do jepen me partneritet publik apo si” agjent tatimor”.

7. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se VKB nr. 02, datë 25.01.2013 “*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat*”, i miratuar dhe konfirmuar mbi bazueshmërinë ligjore edhe nga Prefekti i Qarkut Berat, është marrë pa u kryer më parë një studim mbi numrin e mjeteve, që mund të parkohen në këto rrugë dhe niveli i të ardhurave që realizohen për një kohë pune 8 – 16⁰⁰, pra mungon planbiznesi mbi mirë përcaktimin e të ardhurave nga ky aktivitet dhe nga kjo sipërmarrje, procedurë kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 10.06.2008, nenin 5 “*Standardet e parkimit për mjetet rrugore*”, pika 6, ku përcaktohet se: “*Numri i kërkuar i parkimeve për çdo zonë të banuar, duhet të përcaktohet nëpërmjet studimeve që do të kryhen nga entet pronare të rrugëve*”, studim ky që rezultoi se nuk është e mundur.

Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa që për të gjitha procedurat e konkurimit që do të kryejë për sipërmarrje publike, të marrë masa e të përcaktojë sipas llogaritjeve të argumentuara pritshmëritë e të ardhurave që do të krijohen, me normativa e përcaktime të llogaritura sipas dispozitave ligjore në fuqi.

8. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se nuk ka një procedurë vendimarrëse nga Këshilli Bashkiak mbi trajtimin e biletës së parkimit dhe procesverbaleve si letra me vlerë, referuar VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 “*Për shtypjen e letrave me vlerë*”, i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 6.04.2011, me VKM nr. 393, datë 18.6.2014 pika 1 dhe 2. Po kështu nuk është zbatuar Udhëzimi nr. 7, datë 10.06.2008, neni 9 “*Pagesa e kohë qëndrimit*”, pika 2, sipas të cilës “*Modeli i biletave të parkimit, karakteristikat, elementet e sigurisë dhe mënyra e shpërndarjes së tyre përcaktohen nga këshilli vendor*”, të ketë një procedurë vendimarrëse nga këshilli për rregullimin e kësaj marrëdhënie.

Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa dhe të vendosë si kusht të veçantë administrimin e përbashkët të biletave dhe procesverbaleve dhe të trajtohen si letra me vlerë, referuar VKM nr. 1497,

datë 19.11.2008 “Për shtypjen e letrave me verë”, i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 6.04.2011, me VKM nr. 393, datë 18.6.2014 pika 1 dhe 2.

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat ka krijuar një marrëdhënie juridike-civile pa pasur listën përfundimtare të pasurive të cilat i kalojnë në pronësi e përdorim të regjistruar në ZVRPP Berat. Në kushtet kur Bashkia Berat, nuk rezulton në cilësinë e pronarit mbi pasurinë por administratorit të saj, lejimin apo pëlqimin e përfaqësuesit të pronarit shtet të deritanishëm, pra të Ministrisë së Ekonomisë, nuk plotësohen kushtet ligjore për krijimin e marrëdhënies së drejtë juridike-civile, lidhjen dhe zbatimin e kontratës. Si pasojë e në referim të neneve 115-116 të K. Pr. Administrative kontrata është nul dhe e pavlefshme.

Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa dhe të kryejë inventarizimin e plotë të rrugëve dhe regjistrimin në ZVRPP bazuar në cilësimet e listës së inventarit të miratuar nga Këshilli Ministrave, ndërkohë me procedura ligjore të revokojë kontratën e nënshkruar me subjektin “M....P...B..” sh.p.k, duke vlerësuar praktika të tjera pozitive më me efektivitet dhe që sjell një efikasitet në menaxhimin e parkimit në qytetin e Beratit.

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i **kërkojmë** Kryetarit të Njesisë së Qeverisjes Vendore, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga Shërbimi Civil**”, për këta punonjës:

1. Znj. **E. P**, me detyrë Kryetare e Komisionit Përzgjedhjes të Agjentit Tatimor që do të vjelë të ardhurat nga parkimet publike me pagesë.
2. Znj. **L.B**, me detyrë anëtare e Komisionit Përzgjedhjes të Agjentit Tatimor që do të vjelë të ardhurat nga parkimet publike me pagesë.
3. **R.K**, me detyrë anëtare e Komisionit Përzgjedhjes të Agjentit Tatimor që do të vjelë të ardhurat nga parkimet publike me pagesë.
4. **B.B**, me detyrë anëtare e Komisionit Përzgjedhjes të Agjentit Tatimor që do të vjelë të ardhurat nga parkimet publike me pagesë.
5. Znj. **M.K**, me detyrë anëtare e Komisionit Përzgjedhjes të Agjentit Tatimor që do të vjelë të ardhurat nga parkimet publike me pagesë.

Për sa më poshtë:

- Kriteri i vendosur nga Komisioni, sipas të cilit Kontrata duhet të lidhej me afat 20 vjeçar, është në kundërshtim me nenin 12 pika 4, të Udhëzimit nr. 7, datë 10.06.2008 “Mbi rregullat kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të Parkimit me pagesë në Rrugë” të ish-Ministrisë Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit”, ku përcaktohet se: “Afati i veprimtarive të administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë, është 5-vjeçar me të drejtë rinovimi ...”, kufizim i cili nuk është marrë parasysh edhe pse në kontratën e shërbimit datë 01.07.2013 afati është korrigjuar nga 20 vjet në 5 vjet. Po ashtu në përcaktimin e këtij kriteri nuk janë marrë parasysh Vendimet e Këshillit Bashkiak, nr. 39, datë 29.10.2010 dhe nr. 26, datë 09.07.2012 “Për rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryej administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë”, pasi edhe këto dy vendime nuk kanë përcaktuar afatin kohor 20 vjet.

- Vendosja e raporteve të fitimit është bërë pa asnjë lloj kriteri apo studimi. Kështu sipas nenit III, të Kontratës “Marrëdhëniet Financiare mes palëve” pika 3.1, është vendosur që palët bien dakord se; të

ardhurat e përfituara do të ndahet me përqindje mes tyre në raportet 80% shoqëria dhe 20 % Bashkia Berat.

VKB nr. 02, datë 25.01.2013 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat*", i miratuar dhe konfirmuar mbi bazueshmërinë ligjore edhe nga Prefekti i Qarkut Berat, është marrë pa u kryer më parë një studim mbi numrin e mjeteve që mund të parkohen në këto rrugë dhe niveli i të ardhurave që realizohen për një kohë pune 8 – 16⁰⁰, pra mungon planbiznesi mbi mirëpërcaktimin e të ardhurave nga ky aktivitet dhe nga kjo sipërmarrje, por i është referuar kriterit të tarifës së parkimit të automjeteve në vend-parkime me pagesë 50 lek/orë, raportit 80% të të ardhurave totale do ti takojnë shoqërisë dhe 20% do ti takojnë bashkisë, si dhe kushtit se shuma vjetore e të ardhurave nga parkimi nuk do të jetë më e vogël se shuma maksimale e të ardhurave të realizuara për parkimin në periudhën që ky shërbim administrohej nga Bashkia Berat, viti 2011 në shumën 3,858,238 lekë), procedurë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 10.06.2008, nenin 5 "*Standardet e parkimit për mjetet rrugore*", pika 6, ku përcaktohet se: "*Numri i kërkuar i parkimeve për çdo zonë të banuar duhet të përcaktohet nëpërmjet studimeve që do të kryhen nga entet pronare të rrugëve*", pasi nuk rezulton të jetë ezauruar.

- Në përcaktimin e kriterëve nuk është marrë parasysh VKB nr. 02, datë 25.01.2013 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat*", i cili ka përcaktuar se: "*Shuma vjetore e të ardhurave e të ardhurave nga parkimi që do të xhirohen nga shoqëria në llogari të bashkisë nuk do të jetë më e vogël se shuma maksimale e të ardhurave të realizuara për parkimin në periudhën që ky shërbim administrohej nga Bashkia Berat, viti 2011 në shumën 3,858,238 lekë*", pasi konstatohet se kushti prej jo më pak se 3,858,238 lekë nuk është vendosur në kriteret e caktuara nga Komisioni dhe Miratuar nga Kryetar i Bashkisë edhe pse në kontratën e shërbimit datë 01.07.2013, ky kusht është përcaktuar dhe sanksionuar në të.

- Nuk është kërkuar që Biletat e parkimit apo dhe procesverbalet të trajtohen si letra me vlerë, referuar kjo VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 "*Për shtypjen e letrave me verë*", i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 6.04.2011, me VKM nr. 393, datë 18.6.2014 pika 1 dhe 2. Nuk është respektuar Udhëzimi nr. 7, datë 10.06.2008, neni 9 "*Pagesa e kohëqëndrimit*", pika 2, sipas të cilës "*Modeli i biletave të parkimit, karakteristikat, elementet e sigurisë dhe mënyra e shpërndarjes së tyre përcaktohen nga këshilli vendor*", kjo pasi nuk rezulton të ketë një procedurë vendimmarrëse nga këshilli për rregullimin e kësaj marrëdhënie.

- Në vendosjen e kriterëve nuk është marrë parasysh Udhëzimi nr. 7, datë 10.06.2008, neni 4 "*Fazat procedurale*", pika "c", sipas të cilës: "*Miratimi i formës së bashkëpunimit me subjektet private dhe përcaktimi i kriterëve bazë nga këshilli vendor, për përzgjedhjen e personave juridikë për kryerjen e veprimtarisë së administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë*", si dhe neni 8 "*Organizimi i administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë*" pika "e", sipas të cilës: "*Këshilli vendor përcakton, kriteret për vlerësimin e propozimeve në procedurën e përzgjedhjes*", pasi nga Këshilli Bashkiak, është përcaktuar vetëm një kriter ai i raportit të përqindjes 80 me 20 dhe niveli minimal i arkëtimit.

Nuk janë zbatuar kriteret e vendosura në Udhëzimin nr. 7, datë 10.06.2008, Kreu III "*Kriteret dhe dokumentacioni për përzgjedhjen e subjektit*", nenin 10 "*Veprimtaritë në fushën e parkimit me pagesë në rrugë*", pika "c", pasi rezulton se si në nenin 4 "*Të drejtat dhe detyrimet e palës së parë*" po ashtu dhe në nenin 5 "*Të drejtat dhe detyrimet e palës së dytë*", por dhe më parë në VKB-të e këshillit apo dhe kushtet dhe kriteret e vendosura për konkurrim, nuk është normuar kjo marrëdhënie, pra nuk është përcaktuar kush ka të drejtën apo detyrimin për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj klauzole.

Nuk janë zbatuar disa nga pikat e Udhëzimit nr. 7, datë 10.06.2008 dhe konkretisht nenit 19 "*Përmbajtja e njoftimit*", pika "b", "*zonat e shërbimit*", pika "d", "*karakteristikat kryesore të shërbimit të kërkuar*", pika "g" "*Mënyrat kryesore të financimit dhe të pagesës*" si dhe pika "h", "*Kriteret e përzgjedhjes dhe sistemin e pikëzimit*", pasi nuk rezulton të jetë bërë një përcaktim i tyre në njoftimin për botim të datës 06.02.2013.

Nga Bashkia Berat, nuk është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH,(afati nuk është ezauruar 20 ditë), **pra rezulton se rekomandimet janë në process vlerësimi e zbatimi.**

*Shënim:*Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Ryisin Xhaja dhe Taulant Dervishaj, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT